



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 2813 Prot.

Lezhë, më 01 . 03 . 2024

VENDIM

Nr. 10, Datë 29. 02. 2024

“PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI NË 6 % PËR PERIUDHEN 01 – 31 JANAR 2024 ”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të ligjit nr.139/ 2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore , të nenit 21, të ligjit nr.57/2019 “Për asistencën në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 597, dt.04.09.2019 “Per përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, VKM nr.565, dt. 09.08.2006 " Për mbrojtjen e shtresave në nevojë nga rritja e çmimit të energjisë elektrike" i ndryshuar, VKM nr. 8, datë 14.01.2015 " Për mbrojtjen e shtresave në nevojë për heqjen e fashës deri 300 KWH në muaj", nga materiali i paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë:

Vendosi:

Miratimin e listës së familjeve për t’u trajtuar me ndihmë ekonomike me anë të fondit të kushtëzuar për bllok –ndihmën ekonomike për muajin **JANAR 2024**.

- Tabelë përmbledhëse sipas Njësave Administrative për trajtimin me ndihmë ekonomike me anë të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% per muajin **JANAR 2024**.

Nr	Bashkia Lezhë/Njësitë	Nr. i familjeve	Masa e ndihmës 6%	Nr. i familjeve që përfitojnë kompensim	Masa e Kompensimit	Shkolla	Totali i Përfituar
1	LEZHË	25	103,154	6	7,728	1,200	112,082
2	SHENKOLL	26	100,854	14	18,032	300	119,186
3	KALLMET	2	9,086	2	2,576		11,662
4	ZEJMEN	4	13,442	3	3,864		17,306
5	BALLDREN	6	19,700	3	3,864	300	23,864
6	SHENGJIN	7	23,144	1	1,288		24,432
7	UNGREJ	7	27,759				27,759
8	DAJÇ	6	37,818				37,818
9	KOLSH	12	66,643	1	1,288		67,931
10	BLINISHT	2	11,066				11,066
	TOTAL	97	412,666	30	38,640	1,800	453,106

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
NDUE LULI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI JURIDIK

Nr. 2813/Prot
DA 05.03.2024

Nr. 212/2 Prot.

Lezhë, më 05.03 2024

Lënda: Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit Nr. 107/2016, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" ligjin nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" VKM-në nr. 597, datë 4.9.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr. 10, datë 29.02.2024 të Këshillit të Bashkisë Lezhë "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok -ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-31 Janar 2024".

P R E F E K T I

Gjergj PRENDI

